

**AKT - THEMELIMI**  
**PER KRIJIMIN E SHOQERISE TREGTARE**  
**ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**  
**« FERMA A&E 2018 » shpk .**

Ne Fier , sot me date 27.11.2018 ( Dymije e Tetembehjete ) , ditën e Marte ne :

- **Andi Koço**, i biri i Nikoll , lindur me 13.06.1987 ne Fier dhe banues ne fshatin Sheqishte , Njesia administrative Zharrez, Bashkia Patos , mbajtes i Leternjoftimi ID me numer 028536205/I70613024G ,
- **Menelaos Semanjaku** , i biri i Arben , lindur me 06.06.1995 ne Fier, Alb dhe banues ne fshatin Sheqishte, Njesia administrative Zharrez, Bashkia Patos , mbajtes i Pasaportes me numer BB8031794 / J50606029K

me iniciativen tone te lire si dhe duke u bazuar ne Kushtetuten e Republikës se Shqipërisë ,Kodin Civil ne fuqi , ne mbeshtetje te Ligjit nr. 9901 date 14.04.2008 “Per Shoqerite Tregtare” , ligjit nr. 9723 date 03.05.2007 « Per Qendren Kombetare te Regjistrimit « ate Doganor ,Fiskal ,Tatimor vendosem te krijojme Shoqerine shqiptare me pergjegjesi te kufizuar per sa me poshte vijon :

**Neni 1**

**Emertimi i Shoqerise**

Shoqeria « **FERMA A&E 2018** » shpk eshte e llojit Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar .

**Neni 2**

**Kohezgjatja e veprimtarise**

Shoqeria « **FERMA A&E 2018** » shpk do te veproje per nje periudhe kohore me shume se 10 vjet.

Me vendim te ortakeve te saj ky afat mund te jete me i shkurter apo mund te zgjatet me tej.

**Neni 3**

**Emertimi dhe qendra ( Selia )**

Shoqeria « FERMA A&E 2018 » shpk do te kete qendren (seline) e saj ne territorin e Republikës se Shqipërisë ne Adresen ; Fshati Sheqishte,Rruga „ Petraq Poshnjari“ Godina nr. 2 ,Njesia Administrative Zharrez,Bashkia Patos .

**Neni 4**

**Objekti i Veprimtarise**

Objekti i veprimtarise se shoqerise do te jete :

*Prodhimi, magazinimi dhe perpunimi i produkteve bujqesore,blegtorale,industriale,tregtimi i tyre brenda dhe jashte vendit.Importimi dhe eksportimi i tyre dhe te tjera si lenda e pare per to, Makineri e pajisje te ndryshme ,perdorimi i tokes bujqesore , ngritja e objekteve te nevojshme per te gjithë veprimtarine e mesiperme .Transport nderkombetar per vete , per te trete dhe me qira . Tregtim artikuj ushqimor me pakice dhe shumice ,importi dhe eksporti i tyre .Prodhim, perpunim dhe shperndarje me shumice e ushqimeve per njerez. Shitje me shumice e ushqimeve me origjine shtazore per njerez . Tregtimi me shumice e pakice i kafsheve te gjalla dhe mbareshtimi i tyre .Tregtim i kafsheve te gjalla per majmeri .*

**Neni 5**

**Regjimi juridik**

Ne te gjithë territorin e saj ne Republikën e Shqipërisë Shoqeria do te udhëhiqet nga legjislacioni shqiptar ne fuqi.

Te drejtat dhe detyrimet e shoqerise dhe te ortakut te saj percaktohen me hollesisht ne Statutin qe i bashkengjitet ketij Akti.

Shoqeria gezon mbrojtje dhe sigurim te plote ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi.

Per evidentimin e veprimtarise se Shoqerise do te perdoren dispozitat ligjore ne fuqi, dhe kerkesat e pergjitheshme te kontabilitetit ,sic sqarohet me hollesisht ne dispozitat perkatese te Statutit te Shoqerise.

Shoqeria fillon veprimtarine e saj vetem pasi te kete marre autorizimin e organeve kompetente sipas legjislacionit ne fuqi .

### **Neni 6**

Ortaket Themeleues

Themelues te shoqërisë janë ortakët themelues të Shoqerisë janë;

- **Andi Koço**, i biri i Nikoll , lindur me 13.06.1987 ne Fier dhe banues ne fshatin Sheqishte , Njesia administrative Zharrez, Bashkia Patos , mbajtes i Leternjoftimi ID me numer 028536205/170613024G ,
- **Menelaos Semanjaku** , i biri i Arben , lindur me 06.06.1995 ne Fier, Alb dhe banues ne fshatin Sheqishte, Njesia administrative Zharrez, Bashkia Patos , mbajtes i Pasaportes me numer BB8031794 / J50606029K.

### **Neni 7**

**Kapitali themeltar , Kontributi , pjeset e kapitalit themeltar .**

7/1 a- Kapitali baze i Shoqerise eshte Ne Lek – 200.000 , 00 ( dyqindmijë ) lek : i ndare dhe formuar ne 2 kuota (pjesë) te barabarta . Vlera nominale e çdo kuote te kapitalit eshte 100 000 leke sejcila . Ortakët themelues te shoqerise zoterojne perkatesisht ;

- Ortaku Andi Koço zoteron 1 kuote ose 50 % te kapitalit te shoqerise me vlere kontributi ne para 100 000 leke .

- Ortaku Menelaos Semanjaku zoteron 1 kuote ose 50 % te kapitalit te shoqerise me vlere kontributi ne para 100 000 leke .

Kapitali i Shoqerise do te ngurtesohet ne Bank pasi kjo Shoqeri te regjistrohet ne QKB.

7/2 Kapitali i shoqerise do te rritet krahas ecurise se saj ekonomike ,financiare si dhe te vendimeve qe do te marrim ne ortakët per ta rritur ate ne te ardhmen.

7/3 Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme me rruge trashegimie , ne rast ndarje pasurore mes bashkeshorteve dhe nepermjet paraardhesve e pasardhesve sipas legjislacionit ne fuqi ne Republiken e Shqiperise .

7/4 Pjeset e kapitalit themeltar ortakët mund t'ua transferojne te treteve vetem ne miratimin e plote te tyre .

7/5 Transferimi i pjeseve te kapitalit themeltar gjithmone duhet bere me akt noterial .

7/6 Fitimi i shoqërisë i përket tërësisht ortakëve të shoqërisë .

Ky fitim do të disponohet lirisht prej tyre, ne baze te raportit te kontributit te tyre ne kapitalin themeltar, pasi të jenë shlyer më parë detyrimet tatuese fiskale dhe ato ndaj të tretëve dhe te jene hequr 5% qe do te futet ne fondin e rezerves ligjore deri ne permbushjen e 1\10 te kapitalit te shoqerise .

### **Neni 8**

**Drejtimi i Shoqerise**

8 Organ drejtues dhe vendimor në këtë shoqëri është Asambleja e Ortakëve .

8/1 Shoqeria do te administrohet dhe drejtohet per nje periudhe 5 (Pese) vjecare me te drejte rizgjedhjeje,nga Administratori i shoqerise ANDI KOÇO, biri i Nikoll, lindur me 13.06.1987 ne Fier dhe banuese ne Sheqishte, Fier me numer personal I70613024G , i cili do te jete drejtues ligjor i saj, si dhe do te perfaqesoje shoqerine ne marredheniet me te tretet Administratori e përfaqëson juridikisht atë në të gjitha organet apo organizmat e aparatit shtetëror dhe në marrëdhëniet me të tretët, kur veprimet kanë të bëjnë me disponimin e interesave materiale të shoqërisë , ka te gjitha kompetencat per te kryer te gjitha veprimet e Administrimit ne interes te shoqerise .Administratori emerohet dhe shkarkohet me miratimin e ortakëve te kesaj shoqerie. Emerimi i tij behet per 5 vjet financiar .Me mirekuptimin e ortakëve ai mund te qendroje si i tille edhe pertej ketij

afati me kusht shqyrtimin formal te kandidatures se tij menjehere pas mbarimit te mandatit 5 vjeçar .Administratori e pushon veprimtarine e tij kur Jep doreheqjen  
Perfundon afati  
Shkel rende e ne menyre te perseritur Statutin , Aktin e themelimit ,dhe ligjet e shtetit shqiptar .

### Neni 9

#### **Sigurimi i Pasurise se Shoqerise**

9/1 Pasuria e shoqerise do te sigurohet ne Institutin e Sigurimeve te Republikes si dhe ne institute te tjera private ekzistuese apo qe do te krijohen ne te ardhmen sipas legjislacionit ne fuqi .

9/2 Masa e pasurise qe do te sigurohet si dhe koha e sigurimit te saj do te vendoset nga Administatori .

### Neni 10

#### **Mbyllja ekonomike vjetore e Shoqerise**

Si rregull, veprimet ekonomike të shoqërisë do të mbyllen më 31 Dhjetor të çdo viti. Përfundim nga ky rregull do të bëhet kur e kërkon organi kompetent ligjor.

### Neni 11

#### **Likujdimi i Shoqerise**

Shoqëria do të shpërbëhet sipas rasteve që do të përcaktohen në statutin e saj.

### Neni 12

#### **Dispozita te pergjithshme**

12/1 Ky akt per Themelimin e Shoqerise ka si pjese te saj edhe Statutin e Shoqerise i cili bashkengjitet dhe depozitohet sipas dispozitave ligjore ne fuqi.

12/2 Ne rastet e likujdimit perfundimtar te Shoqerise ,sipas legjislacionit ne fuqi ,pushon se vepruar edhe ky Akt - Themelimi .

12/3 Adresa ligjore e shoqerise eshte : Fshati Sheqishte,Rruga „ Petraç Poshnjari“ Godina nr. 2 ,Njesia Administrative Zharrez,Bashkia Patos.

12/4 Çdo ndryshim apo shtese qe mund ti behet ketij Akti per Themelimin e saj duhet te behet me shkrim ,te nenshkruhet nga ortaket e saj dhe te depozitohet si ne dokumentat e shoqerise qe mbahen ne Qendren e saj,ashtu edhe ne QKB perkatese .

12/5 Te gjitha mosmarreveshjet qe nuk mund te zgjidhen me mirkuptim ,do te paraqiten per zgjidhje ne Gjykatën kompetente Shqiptare ne perputhje me legjislacionin ne fuqi .

Ky Akt Themelimi i shoqerise u printua ne kater kopje te barabarta dhe u nenshkrua nga ne ortaket e shoqerise me vullnet te lire dhe te plote .

**ORTAKET E SHOQERISE**

Andi Koco

Menelaos Semanyaku

HA

A